Datë: 18.09.2026

Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të në Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe nenit 14 të paragrafit 6 të Rregullores (QRK) nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin, me datë 18.09.2026 publikon këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

1. Kandidatët për ekspertë të jashtëm të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, pozita Drejtor i përgjithshëm me Nr. të Referencës RN00020132, në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

1.1. të kenë diplomë universitare të arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor);
1.2. të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
1.3. të mos jetë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike;
1.4. të mos jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale me dashje;
1.5. të mos jetë i punësuar në shërbimin civil;
1.6. të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore, si dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë në institucionin publik.

Anëtari i komisionit të pranimit që nuk është shërbyes civil, kompensohet në lartësinë prej 250 euro për gjithë procedurën e rekrutimit. Në rast se eksperti i jashtëm nuk merr pjesë deri në përfundimin e procedurës, pagesa bëhet vetëm për zëvendësuesin që vazhdon procesin, në pajtim me dispozitat e nenit 14 paragrafit 6 të të Rregullores (QRK) nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin.

Afati për dorëzimin dokumenteve përcjellëse sipas pikët 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, është i hapur nga data 18/09/2026 deri më datë 25/09/2026 deri në ora 16:00.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.
Kandidatët e interesuar për aplikim për ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: bhasani@kosovo-mining.org;

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 240 252 -136

Ju faleminderit!